



Pranuar / Dërguar Punë/Prodata Received/Delivered	07.12.2023	3 viti god year	
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKEL	7349/2023		1/7



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1268/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1268/2023 të datës 10.10.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër

Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.1268/2023 e datës 10.10.2023 e parashtruar nga ankuesja.
- II. **Anulohet** Vendimi me Nr. 1557 i datës 28.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore, Raporti për Renditjen përfundimtare të kandidatëve dhe Njoftimi i datës 12.09.2023 për kandidatët e suksesshëm dhe të gjitha veprimet juridike-procedurale të ndërmarra nga faza e verifikimit paraprak deri në rezultatet përfundimtare, ndërsa lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *ri-vendosje* në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- III. **Obligohet** Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik i Ministrisë së Punëve të Brendshme, të ndërmarr veprimet e nevojshme në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke e zhvilluar procedurën e pranimit për grupin "*Specialist i Arsimit për pozitën Inspektor i Arsimit në SIA-Prishtinë-dy (2) pozita*", nga faza e verifikimit paraprak.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

### A r s y e t i m

Ministria e Punëve të Brendshme më datë 05.05.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00011609 për grupin Specialit i Arsimit për pozitën "Inspektor i Arsimit" në SIA-Prishtinë, dy (2) pozita, ku afati për aplikim ka qenë nga data 26.05.2023 deri më datë 05.06.2023.

Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, ndërsa pas përfundimit të procedurës sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 12.09.2023, rezulton se kandidatja nga të gjitha fazat është vlerësuar me gjithsej 66.8 pikë, nga rezulton se nuk janë në mesin e katër (2) kandidatëve me më së shumti pikë, rrjedhimisht rezulton se e njëjta nuk është kandidat e suksesshëm.

Ankuesja e pakënaqur me procedurën e vlerësimit, ka parashtruar ankesë pranë Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialit i Arsimit, përmes Vendimit me Nr.1557 të datës 28.09.2023 ka refuzuar ankesën e ankueses, ndërsa ankuesja ndaj të njëjti vendim me datë 10.10.2023 parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave ligjore gjatë procedurës së rekrutimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.10.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, ndërsa Këshilli më datë 23.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 22.11.2023 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë vendimin VK/2023 përmes të cilit ankesës së ankueses A.nr.1268/2023 ia ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 6479/2023 të datës 10.10.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga për [ankesa.kpmschck@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmschck@rks-gov.net) i datës 10.10.2023; Ankesa e ankueses drejtuar DMZP/DZHRI i datës 14.09.2023; Vendim me numër nr.1557 i datës 28.09.2023 i Kryesueses së Komisionit të Pranimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme; Njoftimi lidhur me pikët e ankueses; Njoftimi lidhur me kandidatët fitues në bazë të vlerësimit profesional nga Komisioni i Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore; Kërkesë për përgjigje në ankesë i datës 20.10.2023; Përgjigje në ankesë i datës 23.10.2023; Ofrimi i dëshmimeve nga DMZP/MPB i datës 23.10.2023; Vendim për emërim të Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin specialist i Arsimit i datës 12.07.2023; Konkurs me nr. reference RN00011609 nga Ministria e Punëve të Brendshme për pozitën "Inspektor i Arsimit"

në Komunën e Prishtinës i datës 05.05.2023; Aplikacioni i i datës 05.06.2023; Vendim nga MASHTI për me numër Referencë 10/05 nr. prot.42/2020 i datës 13.03.2020; Pasqyrë e notave nga Kolegji AAB për Xh.Q.; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për Xh.Q. me numër nr.83 i datës 15.03.2005; Certifikatë nga MASHT për Xh.Q. e muajit Korrik 2020; Certifikatë nga MASHT për Xh.Q. e muajit shtator 2019; Certifikatë nga Kec për Xh.Q. i datës 20.10.2017; Certifikatë nga MASHT për Xh.Q. e vitit 2019; Certifikatë nga MASHT për Xh.Q. e muajit Qershor 2014; Vërtetim i përvojës së punës nga Drejtori i SHFMU "Ernest Koliqi" Komuna e Lipjanit për Xh.Q. me nr. prot. 01/1328 i datës 05.12.2022; Certifikatë nga ECDL Kosova për Xh.Q. i datës 02.11.2010; Certifikatë nga ketnet për Xh.Q. i datës 30.09.2017; Certifikatë nga ECDL Kosova për Xh.Q. i datës 23.07.2010; Certifikatë nga FLC për Xh.Q. i datës 10.05.2006; Letër referencë nga Drejtori i shkollës SHFMU "Ernest Koliqi" Komuna e Lipjanit për Xh.Q. i datës 05.12.2021; Letërnjoftim i Xh.Q.; Vërtetim për masë disiplinore nga Drejtori i SHFMU "Ernest Koliqi" Komuna e Lipjanit për Xh.Q. me nr. prot. 01/1329 i datës 05.12.2022; Fatura e tatimit në pronë e Xh.Q. i datës 23.01.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e Xh.Q. i datës 24.05.2023; E-mail nga I.P. për Xh.Q. i datës 13.09.2023; E-mail nga I.P. për Xh.Q. i datës 12.09.2023; Njoftim nga MPB/DMZP i datës 12.09.2023; Lista e aplikantëve nga Simbnj lista e gjerë dhe e ngushtë e kandidatëve; Vendim me numër VK/2023 me numër protokolli 7063/2023 i datës 22.11.2023; E-mail nga A.K. për C.Z. i datës 06.12.2023; E-mail nga C.Z. për A.K. i datës 06.12.2023; Vlerësimi nga anëtarët e Komisionit për ankuesen; Aplikacioni i A.T. i datës 27.05.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për A.T. me numër nr.263 i datës 18.04.2018; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për A.T. me numër nr.6178 i datës 21.07.2022; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për A.T. me numër nr.1089 i datës 25.02.2013; Licencë e mësimdhënësit nga MASHT për A.T. i datës 14.03.2021; Pasqyra e llogarisë së Trustit e A.T. i datës 16.01.2014-23.05.2023; Aplikacioni i B.K.B. i datës 30.05.2023; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për B.K.B. me numër nr.524 i datës 06.11.2017; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës për B.K. me numër nr.399 i datës 16.03.2009; Licencë e mësimdhënësit nga MASHT për B.K.B. i datës 01.03.2018; Pasqyra e llogarisë së Trustit e B.K.B i datës 24.03.2009-30.04.2023;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se lënda ku ankuesja është palë në procedurë, duhet të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* tek organi i njëjtë, *sepse*:

Kolegji i Këshillit në kontekst të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses analizoi kriteret e konkursit për pozitën përkatëse të punës dhe konstatoi se kriteret formale për pozitën e punës Specialist të Arsimit për pozitën "*Inspektor i Arsimit*", në Komunën e Prishtinës për dy (2) pozita me numër të referencës RN00011609, Kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve;

Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës;

Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 2 (dy) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës, me theks të veçantë përvoja e punës në mësimdhënie;

Kolegji i Këshillit, me qëllim të verifikimit të ligjshmërisë së shpalljes së konkursit ka analizuar dispozitat e Rregulloren (QRK) Nr.10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil ndërlidhur me Shtojca Nr.1/6: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 1, kërkesat e përgjithshme formale janë të përcaktuara si në vijim: *a) Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve. Diplomë e nivelit të pestë të KKK, për profesione deficitare (TIK); b) Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. c) Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës,* dhe ka ardhur në përfundimin se konkursi i kontestuar nga ankuesja, në parim shpallja dhe kriteret e përcaktuara të tij kanë qenë në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara të ligjit material të ndërlidhura edhe me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Ndërlidhur me plotësimin të kërkesave të përgjithshme formale të konkursit nga kandidatët në procedurë, Kolegji i Këshillit konstaton se përveç kërkesave për përgatitje profesionale dhe përvojën e punës si kërkesë e përgjithshme formale, lidhur me kriterin që kandidatët duhet të posedojnë *Licencë e mësimdhënësit të kualifikuar në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës,* Kolegji i Këshillit, vlerëson se licenca duhet të jetë valide apo e vlefshme me rastin e aplikimit respektivisht përzgjedhjes.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pas zhvillimit të procedurës së rekrutimit, sipas Njoftimit të datës 12.09.2023 të Komisionit të Pranimit për Institucionet e Administratës Shtetërore, për grupin Specialistë të Arsimit-Inspektor i Arsimit në SIA-Prishtinë, janë bërë publike rezultatet e kandidatëve të suksesshëm në këtë procedurë të rekrutimit, si në vijim: A.T. me gjithsejtë 85 pikë, B.K.B. me gjithsejtë 81.8 pikë.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe verifikimit nëse kandidatët e suksesshëm i kanë plotësuar kriteret e përcaktuara të konkursit ka analizuar dosjen e kandidatit të suksesshëm A.T. dhe ka gjetur se i njëjti posedon Diplomën me Nr. 6178 të datës 21.07.2022 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 05.07.2022 studimet themelore në Fakultetin e Edukimit duke marr titullin Bachelor i Teknologjisë Informatikës, Diplomën me Nr. 263 të datës 18.04.2018 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 06.04.2018 studimet Master i Edukimit duke marr titullin Mësimdhënie dhe Kurrikula, sa i përket përvojës së punës rezulton se sipas dëshmive ka përvojën e punës në mësimdhënie, posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100023606 të lëshuar më datë 14.03.2016 me vlefshmëri deri më datë 14.03.2021.

Kandidatja tjetër e suksesshme B.K., posedon Diplomën Nr.399 të datës 16.03.2009 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 10.11.2008 studimet themelore në Fakultetin e Filologjisë duke marr titullin Bachelor i Gjuhës dhe Letërsisë Frenge dhe po ashtu posedon Diplomën me Nr.524 të datës 06.11.2017 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 18.10.2017 studimet Master i Shkencave Filologjike, sa i përket përvojës së punës sipas dëshmive rezulton se ka përvojën e punës në mësimdhënie, dhe posedon Licencën e Mësimdhënësit me Nr.100011543 të lëshuar më datë 01.03.2013 me vlefshmëri deri më datë 01.03.2018.

Po ashtu, ankuesja posedon Diplomën Nr.83 të datës 15.03.2005 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se ka përfunduar më datë 02.03.2005 studimet themelore në Fakultetin e Mësuesisë duke marr titullin Profesor i Mësimit Klasor, dhe Pasqyren e Notave nga Kolegji AAB Programi Politikat Sociale dhe Mireqenia e Fëmijëve i datës 03.04.2021, sa i përket përvojës së punës sipas dëshmive rezulton se ka përvojën e punës në fushën e arsimit, posedon Vendimin e MASHTI me numër Reference 10/05 të datës 13.03.2020 ku i përtrihet Licenca e Mësimdhënësit, me vlefshmëri nga data 13.03.2020 deri më datë 12.03.2025.

Nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton se sipas konkursit të shpallur të datës 05.05.2023 me shifër reference RN00011609 afati për aplikimi ka qenë nga data 26.05.2023 deri me datë 05.06.2023 nga rrjedh se ndërmjet kësaj periudhe kanë aplikuar edhe kandidatet në këtë procedurë, e si rrjedhojë me rastin e aplikimit dy prej kandidatëve të suksesshëm, respektivisht kandidati A.T. e ka pasur Licencën e mësimdhënësit të pavlefshme me rastin e aplikimit, po ashtu kandidatja tjetër B.K.B e ka pasur Licencën e mësimdhënësit të pavlefshme me rastin e aplikimit bazuar në shkresat e lëndës të ofruara nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik.

Tutje, Ministria e Arsimit Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit konkretisht Ministrja e kësaj ministrie më datë 16.06.2023 ka nxjerr Udhëzimin Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemimin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie, ku në nenin 13 paragrafi 6 është përcaktuar se: *"Licencat e karrierës së mësimdhënësve të lëshuara gjatë viteve 2012-2022, vazhdojnë për 5 vite. Këto licenca mbeten të vlefshme deri në realizimin e procesit të brendshëm të VPM-së"*, me nenin 14 të këtij udhëzimi është shfuqizuar Udhëzimi Administrativ 05/2017, ndërsa sipas nenit 15 të këtij udhëzimi, është përcaktuar se: *"Ky Udhëzim administrativ hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës"*, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, me qëllim të sqarimit të rrethanës juridike lidhur me vlerësimin e licencave të mësimdhënësve që ju ka skaduar afati e të cilët janë përfshirë në fazat e mëtejshme të rekrutimit, kemi kërkuar informata zyrtar nga Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë se mbi bazë të cilit dokument janë vlerësuar këto licenca, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë më datë 05.12.2023 njofton se: *Lidhur me pyetjen tuaj se si kemi bërë vlerësimin e licencave të mësimdhënësve të cilëve ju ka skaduar afati, a ka ndonjë dokument nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit si ministri përgjegjëse për lëshimin e licencave lidhur me këtë çështje, ju informojmë se Departamenti për Menaxhimin Zyrtarëve Publik, duke u bazuar në paragrafin 6 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it me nr. 14/2023, për sistemimin e licencave dhe karrierës i cili përcakton: "Licencat e karrierës së mësimdhënësve të lëshuara nga vitet 2012-2022, vazhdojnë për 5 vite. Këto licenca mbeten të vlefshme deri në realizimin e procesit të brendshëm të VPM". Andaj Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik ka pranuar të gjitha licencat e mësimdhënësve gjatë verifikimit.*

Duke marr parasysh këtë rrethanë, më datë 17.11.2023 kemi kërkuar nga përfaqësuesit e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës informatën nëse Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr.14/2023 për Sistemimin e Licencimit dhe Karrierën në Mësimdhënie është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, mirëpo të njëjtën ditë kemi pranuar informatën zyrtare se *"Udhëzimi Administrativ në fjale nuk gjendet i publikuar në ëeb portalin e Gazetës Zyrtare, gjithashtu të gjitha aktet të cilat vijnë për publikim në portalin e Gazetës Zyrtare zakonisht publikohen brenda ditës"*, andaj nga vlerësimi i dosjeve të kandidatëve dhe konstatimeve të dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit konstaton se nga informata e dhënë nga zyrtarët e Gazetës Zyrtare



të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit arrin në përfundimin se ky udhëzim meqenëse nuk është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe si rrjedhojë nuk është në fuqi dhe i njëjti nuk ka mundur të prodhoje efekte juridike.

Prandaj, duke marr për bazë dispozitat e nenit 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përcaktohet se: *“Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për aplikim. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga Njësia Përgjegjëse, në bazë të dokumenteve të paraqitura si pjesë e aplikimit dhe verifikimeve të tjera sipas detyrës zyrtare që ndërlidhen me verifikimin paraprak. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak, Njësia Përgjegjëse përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim. Vetëm kandidatët që plotësojnë kushtet për aplikim kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin në fazën e mëtejshme, e cila njihet si lista e ngushtë”* Kolegji i Këshillit ka konstatuar se Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, me rastin e përfshirjes së kandidatëve A.T. dhe B.K.B, në listën e ngushtë të cilëve iu ka munguar vlefshmëria e licencave të mësimdhënësit, ka vepruar në kundërshtim me parimet e përgjithshme të pranimit të përcaktuara me nenin 6 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, si rrjedhojë procedura e rekrutimit që nga faza e verifikimit paraprak e tutje është zhvilluar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura të ligjit material dhe 15 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores Nr.16/2020 Për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Nisur nga konstatimet e dhëna si më lartë dhe nga vlerësimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se akti i goditur nga ankuesja në Këshill, gjegjësisht Vendimi me Nr.1557 i datës 28.09.2023 i Komisionit të Pranimit në Institucionet e Administratës Shtetërore për grupin Specialist i Arsimit, janë nxjerr në kundërshtim me dispozitat Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe depozitave të nenit 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase nuk ka vërtetuar drejtë gjendja faktike mbi bazën e provave materiale, andaj ky vendim është i paligjshëm në kuptim të nënti 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, Kolegji i Këshillit, konstaton se pranimin në shërbimin civil sipas konkursit numër Reference: RN00011609 për grupin Specialistë të Arsimit-Inspektor i Arsimit në SIA-Prishtinë, nga faza e verifikimit paraprak e tutje është zhvilluar në kundërshtim me parimet për pranim në shërbimin civil, siç parashihet me nenin 6 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenit 4 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *“1. Pranimi dhe avancimi në karrierë në shërbimin civil bazohet në parimet e mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të drejtë e proporcional gjinor dhe të pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë. 2. Njësia e pranimit civil pranohen dhe avancohen në karrierë në bazë të meritës të vlerësuar në bazë të një procedure konkurruese dhe transparente, të përcaktuara në bazë të Ligjit dhe akteve përkatëse nënligjore”,* kështu që si rezultat i shkeljeve të evidentuara, Kolegji i Këshillit ka marr vendim sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, që lëndën ka kthejë në rishqyrtim dhe rivendosje në fazën e verifikimit paraprak, duke anuluar njoftimin e datës 12.09.2023 dhe listën e ngushtë, duke anuluar Raportin e renditjes përfundimtare të kandidatëve dhe Njoftimin e datës 12.09.2023 të kandidatëve të suksesshëm.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-


048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.1268/2023

Çlirim Zeka

  
Procesmbajtës



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankueses
- Departamentit për МЕНЕДЖИМЕНТ e Zyrtarëve Publikë në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

